



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201400961/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandojmë të shikohet mundësia e shpejtimit të procedurave gjyqësore në gjykimin e çështjes penale me Nr.00356/14 akti, dt.05.03.2014 me të gjykuar K. Gj. nga Tirana.*

**Drejtuar :** **Z. Rubin BAQLI**  
**Kancelar i Gjykatës së Lartë**

**TIRANË**

***I nderuar Z. Baqli,***

Në ankesën e tij datë 07.05.2014 drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, i dënuari K. Gj. i cili vuan dënimin me 4 vjet e 8 muaj burg në Burgun e Vaqarrit Tiranë, ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe për shkeljen e procedurave gjyqësore ndaj Gjykatës së Lartë në gjykimin e një çështje penale ndaj tij dhe 3 personave të tjerë që pretendon se janë dënuar padrejtësisht.

Nga studimi me kujdes i këtij problemi rezultoi se :

Me vendimin gjyqësor Nr.597 datë 24.10.2011 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër është vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurit Kristian Gjyrgji për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve e kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në fazën e tentatives, parashikuar nga nenet 283/2 e 22 të K.Penal dhe në nenin 388 të K.Pr.Penale, **pasi fakti nuk përbën veprë penale.**

Me vendimin e saj Nr.379 datë 21.10.2013 Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur : **Ndryshimi i vendimit Nr.597 datë 24.10.2011 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, në këtë mënyrë :**

1.Deklarimin fajtor të të pandehurit K. Gj. për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike e kryer në bashkëpunim mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/2 e 22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të KPrP e dënon përfundimisht **me 4 vjet e 8 muaj burgim.**

2.Deklarimin fajtor të të pandehurit S. H. për kryerjen e veprës penale të të prodhimit dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/2 22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit Procedurës Penale, dënimin përfundimisht **me 4 vjet e 8 muaj burgim.**

3.Deklarimin fajtor të të pandehurit A. H. për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitja e narkotikëve” të kryer në bashkëpunimin mbetur në

tentative parashikuar nga nenet 283/2 e 22 të K.Penal dënimin e tij me 7 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPrP dënimin përfundimisht të të pandehurit A. H. **me 4 vjet e 8 muaj burgim.**

4.Deklarimin fajtor të të pandehurit N. H. për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitja e narkotikëve të kryer në bashkëpunim mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/2 e 22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim.Deklarimin fajtor të pandehurit N. H. për prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake parashikuar nga neni 278/2 të K.Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.

Në aplikim të nenit 55 të KP dënimin e tij me 7 vjet e 5 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të KPrP dënimin përfundimisht N. H. **me 5 vjet burgim.**

Rezulton se të pandehurit K. Gj. dhe N. H. janë gjykuar e dënuar në mungesë nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Ndaj këtij vendimi gjyqësor të marrë në mungesë të tyre të pandehurit kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar prishjen e këtij vendimi si të padrejtë dhe të pa bazuar në ligj.

Kjo çështje gjyqësore ndodhet e regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë Tiranë me Nr.00356/14 akti, datë 05.03.2014.

Me këtë vendim gjyqësor të Gjykatës Apelit Shkodër janë gjykuar dhe dënuar padrejtësisht 4 persona dhe duke studjuar përmbajtjen e vendimit të tyre del se Gjykata e Apelit Shkodër ka keq interpretuar dispozitën ligjore të nenit 283/2 të K.Penal.

Gjykata e Shkallës së parë Shkodër pasi ka analizuar elementët e figurës së këtij krimi ka konkluduar se mungon objekti i tij. Kjo provohet me akt ekspertimin kimik Nr.1025 datë 08.02.2011 të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Shkencore Tiranë, ku thuhet:

”Nga analiza GC/MS për pluhurin objekt ekspertimi tregoi praninë e Lidokainës. Referencat për klasifikimin në lëndë narkotike apo jo që gjenden në Ligjin me Nr.7975 datë 26.07.1995”Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”. Duke ju referuar ligjit të sipërcituar dhe konkretisht Tabelës nr.1 dhe 2 si dhe nenit 11 dhe 12, rezulton se **“Lidokaina” nuk përfshihet tek Tabela Nr.1 dhe tabelat e tjera, pra nuk bën pjesë në grupin e lëndëve narkotike e psikotrope, referuar ligjit të sipërcituar.**

Në doktrinën e të drejtës penale, thuhet se personi për të patur përgjegjësi penale për një vepër penale duhet të ekzistojnë patjetër 4 elementët e veprës penale, si objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive, mungesa e njerit prej tyre bën që personi të përjashtohet nga përgjegjësi penale.

Në rastin konkret të pandehurit dhe avokati mbrojtës i tyre në rekurs pretendojnë se vendimi gjyqësor është marrë në kundërshtim me ligjin, dhe se Gjykata e Apelit Shkodër ka gabuar dhe zbatuar keq ligjin dhe se ky vendim është marrë në shkelje të rënda të dispozitave ligjore materiale dhe procedurale.

Pra, duke qënë se lënda që është sekuestruar të pandehurëve nuk është lëndë narkotike atëhere me të drejtë konstatohet se nuk është cënuar ndonjë marrdhënie juridike që mbron kontrollin mbi prodhimin, importimin, eksportimin shitjen apo përdorimin e lëndëve narkotike apo substancave psikotrope. Që këtë rrjedh se mungon një elementë shumë i rëndësishëm i figurës së veprës penale të parashikuar nga nenin 283/2 i K.Penal. Neni 283 i K.Penal është një vepër materiale, pra duhet të ekzistojë objekti material konkret që në rastin në fjalë duhet të jetë lëndë narkotike ose psikotrope e cila mbahet në mënyrë të kundraligjshme nga autori i veprës penale.

Ky vendim gjyqësor përbën një nonsensus juridik për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material penal. Gjykata në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim të plotë me përmbajtjen e vet dispozitës së nenit 283/2 të K.Penal. Për ekzistencën e kësaj figure krimi duhet patjetër prania e substancave të lëndës narkotike dhe psikotrope dhe të farërave të bimëve narkotike. Pa praninë e këtij fakti kjo vepër penale, nuk mund të quhet e konsumuar.

Edhe vet i pandehuri K. Gj. dhe avokati mbrojtës i tij në rekursin e ushtruar kanë pretenduar se vepra penale e prodhimit dhe shitjes së lëndës narkotike është një vepër pa objekt, pasi mungon vetë lënda narkotike dhe si e tillë duke qënë se malli i bllokuar nuk është e tillë mungon një element kryesor i kësaj figure krimi që është objekti i tij.

Si konkluzion mendojmë se akuza e ngritur ndaj të pandehurit K. Gj.i në bazë të nenit 283/2 të K.Penal, nuk qëndron pasi ajo në vetvete nuk përbën vepër penale. Meqenëse në rastin konkret konstatohet shkelje të rëndë të ligjit material penal të kryer nga Gjykata e Apelit Shkodër, që përbën një gabim njerëzor nga trupi gjykues u mendua të ndërhyhet me rekomandim në Gjykatën e Lartë për të parë mundësinë e shpejtimit të procedurave të gjyqimit të kësaj çështje, sa më shpejt në të ardhmen.

E drejta për tu gjykuar para një gjykate kompetente të pavarur dhe të paanëshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por ajo të shihet se po bëhet. Në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet e drejta e një gjyqimit të drejtë dhe publikë dhe brenda një afati të arsyeshëm. **Në rastin konkret duke menduar se të 4 të gjykuarit janë të pafajshëm për veprën penale të akuzuar, ky rast të konsiderohet nga ana e juaj si një rast i veçantë për tu shpejtuar gjykimi i saj në të ardhmen nga Gjykata e Lartë në mbrojtje të të drejtave të Njeriut.**

Në nenin 60/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se :”Avokati i Popullit, mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”. Ndërsa në nenin 63 pika 3 të kësaj Kushtetute, parashikohet se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”.

Në nenin 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, përcaktohet se:”Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe

kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Për sa më sipër, Ju

### **REKOMANDOJMË :**

1.Të shikohet mundësia e shpejtimit të procedurës gjyqësore në gjykimin e çështjes penale me Nr.00356/14, akti date 05.03.2014 me të pandehur K. Gj. nga Tirana.

2.Mbi qëndrimin dhe masat që do merren në lidhje me rekomandimin tonë në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avoaktin e Popullit”, lutemi na njoftoni me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**